



Press Release

Berlin, 10 tetor 2008

Perfaqësuesi I posacëm I BE-së, Pieter Feith dhe Shefi I EULEX Kosova, Yves de Kermabon, u takuan sot me median në Berlin me rastin e pjesëmarrjes së tyre në konferencën e mbajtur në Bundestag, me titull “Kosova – 120 ditë pas miratimit të Kushtetutës”.

Përfaqësuesi I posacëm I BE-së, Pieter Feith, tha: "E ardhmja e Kosovës, si pjesë e rajonit të Ballkanit Perëndimor, është në Bashkimin Evropian. Në vijimësi me perspektivën e saj evropiane, Kosova ka bërë përparim të mirë në muajt e fundit duke ndjekur agjendën e saj të gjithanshme të reformave, duke synuar ndërtimin e një shoqërie në të cilën gjithkush ndjehet I sigurtë dhe në të cilën të drejtat e të gjithë komuniteteve respektohen, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal. Është e rëndësishme që qeveria të mbajë momentumin në ndërmarrjen e reformave të nevojshme për këtë. BE-ja do të vazhdojë mbështetjen politike, financiare dhe teknike për këtë process."

Shefi i EULEX Kosova, Yves de Kermabon tha: “EULEX-si vazhdon aktualisht të intensifikojë dislokimin dhe ne parashikojmë të jemi operacionalë nga fundi I vjeshtës. EULEX-si është një mission teknik I sundimit të ligjit, I mbështetur nga të gjithë 27 vendet anëtare të BE-së, që do të zhvillojë më tej dhe do të forcojë një system të pavarur dhe shumë-etnik të sundimit të ligjit nga I cili do të përfitojnë të gjitha komunitetet në Kosovë. EULEX-I do të dislokohet brenda kornizës së rezolutës 1244 dhe nën ombrellën gjithëpërfshirëse të Kombeve të Bashkuara”.

Për një transcript të plotë të fjalimit të shefit të EULEX Kosova Yves de Kermabon, kliko [ketu](#)

Kontakte për media:

Julia Rueter, zëdhënëse e Përfaqësuesit të Posacëm të BE-së,
+377 44 509 760; julia.rueter@eusrinkosovo.eu

Karin Limdal, ZV.shefe e Zyrës për media dhe informim public të EULEX-sit në Kosovë,
+377 44 799 247; karin.limdal@eupt-kosovo.eu

www.euinkosovo.eu